



# MINUTAT E MBLEDHJES

17 SHKURT 2023

ORA 10:00

SEKRETARIATI KOMBËTAR EITI

## TË PRANISHMIT

---

**Z. Genci Tërpo**, Drejtues i Sekretariatit Kombëtar EITI

**Z. Robert Beshello**, Specialist në Drejtorinë e Minierave të Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore

**Znj. Anila Hajnaj**, Drejtues i Qendrës Shqiptare për Zhvillim dhe Integrim

**Z. Sami Nezaj**, Drejtues i Qendrës për Transparencë dhe Informim Falas

**Znj. Ola Mitre**, Drejtues i Shoqatës Grave për Mbrojtjen e Burimeve Natyrore

**Z. Lorenc Gordani**, Drejtues i Qendrës Shqiptare për të Drejtën Ndërkombëtare

**Z. Përparim Alikaj**, Kryetar i Komitetit të Minierave të Naftës dhe Gazit të FIAA-s

**Z. Dritan Dervishaj**, Menaxher i mjedisit dhe guroreve

**Z. Bilal Koçi**, Drejtor i Drejtorisë së Burimeve Minerale

**Znj. Borana Antoni**, Përgjegjës në Sektorin e Monitorimit të Lejeve dhe Licensave në Fushën e Mjedisit, Ministria e Mjedisit

**Znj. Mimoza Sallaku**, Drejtor i Drejtorisë së Analizave Kontabël

**Znj. Mariola Kito**, Menaxher i Burimeve Njerëzore & Administrimit dhe Pajtueshmërisë

**Z. Gledis Kalemi**, Përgjegjës Sektori në Drejtorinë e Tarifave dhe Çmimeve

**Z. Lluka Gjergo**, Koordinator EITI Albania

**Z. Ardit Kamberi**, Koordinator EITI

**Znj. Selma Ago**, Shef Sektori EITI Albania


**Znj. Emiliana Kola**, Specialiste e Burimeve Njerëzore EITI Albania

**Znj. Majlinda Balla**, Specialiste Finance EITI Albania

**Znj. Kristiana Kërthi**, Specialist EITI

**Znj. Xhorxhina Çota**, Specialist EITI

# FOTO NGA MBLEDHJA



**Çështjet e trajtuara në mbledhjen me MSG-ën e zhvilluar në orën 10:00 , më 17 Shkurt 2023:**

1. *Diskutimin për adoptimin e Raportimit Fleksibël për Raportet EITI 2019,2020 dhe 2021 ;*
2. *Miratimi i Listës së Kompanive për raportin e vitit 2021;*
3. *Marrja e të dhënave për Raportet EITI 2019,2020 dhe 2021 në mënyrë të njëanshme;*
4. *Diskutim dhe Vendimmarrje për besueshmërinë e të dhënave në Raportet EITI (Kërkesa 4.7 e Standartit EITI);*
5. *Diskutim dhe Vendimmarrje për përcaktimin e termit “Projekt” për raportimin EITI;*
6. *Diskutim dhe Vendimmarrje për veprimin korigjues të Validimit nr.4 (Kërkesa 2.2 a.i.v e Standartit EITI)*

**Z. Genci Tërpo:** Përshendetje të gjithëve! Mirëmëngjesi! Duke qenë se pjesa më e madhe e pjesëmarrësve të MSG-ësë janë prezent në mbledhje, mendoj se mund të fillojmë. Do të kemi parasysh që e kemi nisur këtë mbledhje në platformën Google Meet e cila ka një gjatësi 50 minuta, që do të thotë nëse mbledhja do të zgjasi dikë më tepër, do ju dërgojmë menjëherë një link tjetër në mënyrë që të log-ohemi dhe të vazhdojmë normalisht mbledhjen. Atëherë pa humbur kohë, besoj se jeni njohur me axhendën e MSG-ësë e dërguar nga znj.Emiliana para disa ditësh . Është një mbledhje që për mua konsiderohet e rëndësishme nga fakti që ne gjatë kësaj periudhe kemi qenë në një bashkëbisedim mjaft të gjatë me Sekretariatit Ndërkombëtar në Oslo, ku kemi diskutuar për mënyrën si do zhvillohet realizimi i Raportit për periudhën e tre viteve, konkretisht për vitin 2019, 2020 dhe vitin 2021. Pra e thënë ndryshe, Shqipëria ka detyrimin që të përgatis Raportin EITI për tre vite, duke qenë se në fillim të vitit tjetër ne jemi në procesin e Validimit, dhe për rrjedhojë, e kemi detyrim që të realizojmë këtë Raport deri më 30 Qeshor të vitit 2023. Pra e thënë ndryshe, koha që kemi për të realizuar Raportin është shumë e shkurtër , dhe nga diskutimet që kemi zhvilluar me Sekretariatit Ndërkombëtar në Oslo, kemi rënë dakord që të realizojmë Raportin Fleksibël EITI, i cili është një raport paksa më i ndryshëm se Raportet EITI që janë bërë vazhdimisht, por që rëndësia e informacionit që jepet aty, ka pothuajse një vlerë të njëjtë dhe mund të realizohet në një kohë shumë më të shkurtër duke qenë se informacioni përgjithësisht përfitohet nga institucione shtetërore, të cilat janë institucionet kopetente për gjenerimin e këtij lloji informacioni. Besoj se të gjithë ne, në këtë mbledhje, jemi në dijeni se si zhvillohet një Raport Fleksibël duke qenë se kjo ishte një risi që u realizua nga EITI ndërkombëtar gjatë kohës së pandemisë për t'i dhënë mundësinë shteteve që të përfitonin realizimin e një Raporti në mungesë të marrjes së të dhënave voluminoze nga shumë burime duke përzgjedhur marrjen e këtyre informacioneve prej burimeve shtetërore. Gjithashtu dhe përzgjedhja e kompanive specifike për të bërë raportim duke mos pasur një grup të gjërë kompanish, siç e kemi pasur historikisht gjatë të gjithë procesit të realizimit të raporteve.

Pika e parë e rendit të ditës do të trajtojmë: *“Diskutimin për adoptimin e Raportit Fleksibël për Raportet EITI 2019, 2020 dhe 2021”*. Pra të gjithë e kuptojmë që këto tre raporte duhet të realizohen dhe koha e realizimit të tyre është mjaft e shkurtër. E thënë ndryshe, ky është një raport që ne jemi të detyruar që ta bëjmë me patjetër, sepse siç jua thash, ne do të jemi në proces Validimi, dhe nëse ne nuk e dorëzojmë raportin brenda afateve të përcaktuara, do të merret një masë për pezullimin e përkohshëm të shteteve që nuk e dorëzojnë raportin. Për rrjedhojë, ne duhet ta dorëzojmë këtë Raport, si dhe e besoj që do e dorëzojmë në kohë, brenda Qershorit të këtij viti.

Keni ndonjë mendim në lidhje me bërjen ose mosbërjen e Raportit Fleksibël?

**Z. Sami Neza:** Çfarë difference ka nga Raporti Normal në Fleksibël ?

**Z. Genci Tërpo:** Ashtu siç u shpjegua më lart, Raporti Fleksibël synon që të marrë të gjithë informacionin nga institucionet shtetërore, duke konsideruar që informacioni i marrë në rrugë shtetërore është informacion i saktë. Kjo është një ndër pikat që ne do të trajtojmë më poshtë. Sigurisht që informacionet e marra në këto rrugë janë informacione të certifikuar, shumë më ndryshe nga disa informacione që do të

vinin në rrugë të tjera.

**Z. Sami Neza:** Qëllimi i iniciativës është diferenca midis dy institucioneve. Për momentin rrethanat na diktojnë të veprimet kështu, por në të ardhmen ne do e mbushim boshllëkun.

**Z. Genci Tërpo:** Kjo lloj initiative është përdorur dhe po përdoret nga një varg shtetesh. Janë shumë shtete që në kushte të veçanta e vështirësojnë procesin e raportimit, kanë përzgjedhur përgatitjen e Raportit EITI. Për mendimin tim, kjo do ishte një iniciativë shumë e mirë, që ne të kuptojmë rëndësinë e përgatitjes së një Raporti Fleksibël dhe për më tepër duhet të kemi parasysh faktin që një raport kërkon kohë të gjatë. Konkretisht ne kemi rreth 80 ditë kohë për të realizuar tre raporte të cilat më parë realizonim rreth një vit për një raport. Është një formë që na është sugjeruar nga diskutimet që kemi bërë me EITI-n Ndërkombëtar që Raportimi EITI është një raport i cili mund të përdoret dhe është në përputhje jo vetëm më kohën, por edhe me mundësitë që ka Shqipëria sot që ne po flasim, për të prodhuar raporte brenda afateve të përcaktuara nga vendimi i Bordit të Sekretariatit EITI.

**Z. Sami Neza:** Besoj që në Raport do shënohen që të dhënat janë të njëanshme dhe mund ti përkasin vetëm njërës palë.

**Z. Genci Tërpo:** Termat e Referencës së Raportit Fleksibël e kanë të përcaktuar këtë fakt. Nga ana tjetër duhet të kuptojmë dhe duhet të biem dakord që a pranojmë që informacionet e marra në institucionet shtetërore janë informacione të sakta?

**Z. Sami Neza:** Kjo gjë nuk është e sigurt, dhe nuk mund ta marrim përsipër 100% të tillë. Ne mund të supozojmë se informacionet janë të sakta.

**Z. Genci Tërpo:** Mendoj që informacionet që merren nga institucionet shtetërore janë të sakta, sepse për të marr informacionin në fjalë, ne do të përdorim burimet shtetërore.

**Z. Sami Neza:** Ajo çfarë ne po bëjmë prek në fjalë thelbin e iniciativës. Kjo është identifikimi i diferencave në raportim, nga biznesi te shteti dhe anasjelltas. E kuptoj shumë mirë, nuk jam kundër për këtë, por unë po diskutoj në mënyrë që të shikojmë se çfarë na mungon kur të bëjmë këtë Raport Fleksibël.

**Znj. Emiliana Kola:** Raportimi Fleksibël na u sugjerua si një zgjidhje nga Sekretariati Ndërkombëtar në mënyrë që të bëjmë raportet duke qenë se jemi në këtë situatë. Pra pikë së pari dhe Termat e Referencës (drafti) është i përgatitur nga ata, ne shtojmë kontekstet shqiptare. Pikë së dyti, në lidhje me atë që folët më lart, që preket thelbi i iniciativës, na është thënë që rikonsilimi ndër vite, nuk ka dhënë ndonjë vlerë të shtuar, sepse raportimet që bëjnë institucionet janë ato që kanë marrë nga kompanitë dhe raportimi që bëjnë kompanitë është pikërisht ajo që kanë paguar dhe na është sqaruar përgjithësisht që gabimet e ndodhura kanë qenë për shkak të gabimeve njerëzore, pra nuk ka pasur një diferencë sinjifikative, apo problem te rikonsilimi. Ka vende të tjera që e bëjnë Raportimin Fleksibël, dhe që gjatë kohës së pandemisë na është sugjeruar që të bënim ose Termat e Referencës klasike ose Raportin Fleksibël. Ne zgjedhëm ti bënim ato klasiket fillimisht me termat që ju i miratuat, dhe tani kemi menduar të vazhdojmë me Raportimin Fleksibël duke qenë se nuk kemi kohë. Ndërkohë për pjesën tjetër që thoni, që për të dhënat shtetërore nuk mund të shprehemi që janë të sakta, ne duhet të marrim një vendim sepse MSG-ja asnjëherë nuk është shprehur që të dhënat janë të besueshme dhe kjo prej vitesh është veprim korrigjues i lënë nga Validimi. Përderisa këto të dhëna janë nga institucione shtetërore dhe janë publikuar, nuk mund të pretendojmë që këto të dhëna nuk janë të besueshme.

**Z. Sami Neza:** Të besueshme mund të themi që janë këto të dhëna, por të sakta mua më duket e tepërt.

**Znj. Emiliana Kola:** Janë të besueshme derisa merren nga burime zyrtare. A janë të sakta, kjo është tjetër gjë. Për saktësinë e të dhënave e mban përgjegjësinë institucioni që i jep të dhënat. MSG-ja duhet të marrë një vendim në lidhje me këtë, sepse e kemi veprim korrigjues për shumë vite dhe ka ngjallur pyetje se cila është arsyeja që Shqipëria nuk shprehet për këtë gjë. MSG-ja duhet të shprehet për këtë pjesë.

**Z. Sami Neza:** Nuk e kuptoj pse ne duhet të marrim një vendim në lidhje me besueshmërinë e statistikave që vijnë nga burime zyrtare. Ne mund të japim një opinion, dhe secili prej nesh mund të thotë që janë shumë të sakta.

**Znj. Emiliana Kola:** Besueshmërinë e të dhënave e kërkon kërkesa 4.9 e Standartit. Kjo çështje nuk kërkohet prej Sekretariatit është një çështje ku MSG-ja duhet të shprehet, vendet e tjera e kanë bërë prej vitesh këtë gjë, ndërsa ne e kemi si kërkesë vit pas viti.

**Z. Genci Tërpo:** Znj.Emiliana kam një pyetje .Që nga fillimet e veprimtarisë së EITI-t e deri aktualisht, është ngritur ndonjëherë si çështje në mbledhjet e MSG-ësë ?

**Znj. Emiliana Kola:** Kjo është ngritur sa herë kemi pasur takime me Validimin, por mesa duket nuk janë sqaruar. Administratori i pavarur ka bërë sikur nuk e ka dëgjuar, ose nuk e ka kuptuar realisht dhe ka ngelur në pritje gjatë gjithë kohës kjo çështje. Aktualisht, duhet marrë një vendim që ta heqim si veprim korrigjues, sepse është një gjë e arritshme prej nesh për tu bërë. Kjo gjë na ka ulur pikëzimin vit pas viti në validim.

**Z. Genci Tërpo:** Për të qenë më të qartë rreth vendimit që ka marrë EITI për sa i përket çështjes së validimit, pjesa më e madhe e vendeve që i janë nënshtruar procesit të validimit kanë pasur një pikëzim të ulët, ose të njëjtë me pikëzimet e mëparshme, në rastin konkret, Shqipëria ka pasur një pikëzim relativisht të lartë, për të cilën jemi përgëzuar nga Sekretariati EITI, duke e konsideruar Shqipërinë si një vend i cili ka bërë progres për sa i përket këtij procesi. Ne kemi dalë shumë mirë në validimin e bërë në vitin 2021-2022, dhe natyrisht kemi disa detyrime për të plotësuar Standartin që siç tha dhe znj. Emiliana është në proces ndryshimi. Pra Standarti i Zhvillimit të Raporteve të tjera që do zhvillohen pas Raportit të 2021, duhet të jetë Standarti i vitit 2023, sepse presupozohet që gjatë këtij viti të ketë një Standart të ri që do të ketë detyrime të tjera për shtetin, por ne kemi detyrimin për të zhvilluar Raportin për të përmbushur kriteret që kërkon Standarti i vitit 2019. Për rrjedhojë, Raporti Fleksibël është në përputhje me Standartin e vitit 2019, sepse Termet e Referencës janë përgatitur nga Sekretariati Ndërkombëtar EITI dhe u janë vënë në dispozicion të gjitha vendeve që kanë implementuar përdorimin e Raportit Fleksibël. E vetmja zgjidhje që ka Shqipëria për të bërë tre raporte në një periudhë relativisht të shkurtër, është përdorimi i Raportit Fleksibël, i cili përmban të dhëna që përmbushnin kriteret e standartit të vitit 2019.

Çfarë vendimi keni për vendimarrjen e besueshmërisë së të dhënave?

**Z. Përparim Alikaj:** Unë mendoj që nëse nuk kemi ndonjë zgjidhje tjetër të pranueshme për këtë gjë, duhet të vazhdojmë me këtë zgjidhje.

**Z. Lorenc Gordani:** Nuk e di nëse e kam kuptuar drejtë, por doja t'ju pyesja se a ka ndonjë vend tjetër që ka deklaruar që të dhënat nuk i ka të sakta? Si është situata e vendeve të tjera?

**Z. Genci Tërpo:** Siç e shpjegoi dhe znj. Emiliana, pjesa më e madhe e vendeve që janë anëtarë të Nismës EITI janë shprehur për sa i përket çështjes së besueshmërisë së të dhënave, sepse presupozohet që kur shkojmë pranë një institucioni shtetëror dhe marrim informacione që vijnë zyrtarisht, të firmosura dhe vulosur nga drejtuesi i atij institucioni, i dalë nga sistemi, ky informacion është i saktë. Ne jetojmë në një shtet ligjor, ku çdo institucion ka një bazë ligjore, ka një proces vendimmarrjeje që është rregulluar me ligj, dhe për rrjedhojë informacioni që përcillet nga këto lloj institucionesh, është informacion i besueshëm.

**Z. Gledis Kalemi:** Dua të saktësoj besueshmërinë e të dhënave për sa i përket sektorit të Energjisë Elektrike. Kemi raportuar të dhëna kur janë kërkuar nga EITI dhe raportet vjetore janë të publikuara lidhur me ato subjekte që janë përzgjedhur për raportim, atëherë të dhënat e këtij sektori përveçse janë të publikuara dhe të besueshme, janë gjithashtu edhe të rakorduara nga operatorët e sistemit përkatës ku janë, sepse për çdo vit ka një bilanc energjistik i cili detyrimisht përputhet mes prodhimit të energjisë elektrike, importit dhe konsumit të saj. Nuk di të them për sektorët e tjerë si hidrokarburët e tjerë, por për sa i përket besueshmërisë së të dhënave të sektorit të Energjisë Elektrike besoj që nuk ka vend si diskutim kjo si çështje.

**Z. Lorenc Gordani:** Atëherë për mua personalisht të dhënat mund të quhen zyrtare, por unë nuk marr përsipër që të them se të dhënat janë të besueshme. Në fakt ne duhet të jemi koshient që Shqipëria ka një nivel të lartë informaliteti, kështu që të dhënat mund të jenë të çfarëdoshme dhe diskutimet për bilancin energjistik kanë qenë ndër vite të diskutuara si të pasakta, gjithsesi ne kemi përfaqësues për institucionet si

AKBN-ja, e cila mbulon të gjitha fushat, hidrokarburet në veçanti, kështu që unë nuk marr përsipër të them dicka të tillë. Unë besoj që auditorët (personat që marrin përsipër të bëjnë raportin) duhet të japin një mendim të saktë sepse ata kanë një ekspertizë rreth kësaj fushe .

**Z. Genci Tërpo:** Atëherë si do shprehemi për çështjen e besueshmërisë së të dhënave?

**Z. Lorenc Gordani:** Personalisht abstenoj, nëse është e mundur.

**Znj. Emiliana Kola:** A duhet ta vazhdojmë ta lëmë si një veprim korigjues të paplotësuar? Një vendim duhet marrë, një alternativë nëqoftëse nuk jeni dakord me konsiderimin e të dhënave shtetërore të besueshme që të vendosim se çfarë të bëjmë konkretisht për ta përmbushur kërkesën e Standartit, sepse nuk mund ta lëmë pezull si çështje vit pas viti këtë gjë .

**Z. Sami Neza:** Kjo është e domosdoshme të votohet sot patjetër?

**Znj. Emiliana Kola:** Z.Sami, nëse do të duhet të vijojmë me termat e Raportimit Fleksibël dhe të vijojmë pastaj me procedurën e prokurimit të administratorit të pavarur dhe me fillimin e Raportit, të gjitha gjërat se çfarë duhet të bëjë administratori dhe se çfarë duhet të përmbajë raporti duhet të përfshihen në Termat e Referencës, kështu që disa vendime që janë bazë, duhen të merren.

**Z. Sami Neza:** Po ne qoftë se ne do të na duhet t'i rikthehemi një herë tjetër çështjes së besueshmërisë së të dhënave, dhe ne të mund të rimarrim në diskutim këtë vendim që mund ta marrim sot për besueshmërinë, a është e mundur dhe kush mund ta iniciojë një gjë të tillë?

**Z. Genci Tërpo:** Paraprakisht EITI ka një eksperiencë gati 13 –vjeçare që operon dhe gjatë kësaj periudhe ne kemi realizuar një varg raportesh, të cilat MSG-ja është njohur dhe ashtu siç përmendi dhe znj. Emiliana dhe administratorët e pavarur nuk kanë konstatuar ndonjë diferencë dhe të vetmet çështje gabimi që kanë qenë, kanë qenë vetëm ato gabimet njerëzore që vijnë nga kompanitë, sepse kompanitë raportojnë atë që përcillet nga institucione të tjera shtetërore, përfshirë AKBN-në kjo do të thotë që informacioni bazë thelbësor dhe kryesor është përgjithësisht informacioni që merret nga institucionet shtetërore, i cili është konstatuar që gjithnjë ka qenë në përputhje me informacionin që merret nga kompanitë. Cili është problem te kjo gjë? Sepse ne këto raporte i kemi prodhuar dhe pikërisht ka dal ajo që është transmetuar nga institucionet shtetërore, e cila është në përputhje me informacionin që merret nga kompanitë.

**Z. Sami Neza:** Unë këto pyetje po i bëj për shkak jo të faktit se nuk janë të dhënat, por për shkak të kontekstit ku ne detyrohemi të marrim këtë lloj vendimi, pa patur kurrëfarë ekspertize, njohjeje dhe përgjegjshmërie nëse janë apo jo të dhënat e sakta. Është e vërtetë ajo që thoni ju që ne i kemi përdorur të gjitha raportet me po këto të dhëna, nga po këto institucione dhe nuk e di pse është e domosdoshme që ne të ratifikojmë këto të dhëna edhe zyrtarisht sepse ne jemi një institucion NGO që nuk mban ndonjë lloj përgjegjshmërie për të dhënë një vendim i cili edhe po t'ja kërkojmë qeverisë e ka paksa të vështirë.

**Z. Genci Tërpo:** Atëherë ideja është që Termat e Referencës të Raportit Fleksibël kërkojnë marrjen e këtij lloj informacioni në këtë formë. Sa herë do të ketë trajtim të realizimit të raportit me terma fleksibël, jemi të detyruar ti marrim këto të dhëna në një kanal, pra në një burim dhe për rrjedhojë jemi të detyruar të shprehemi se pse po i marrim në një kanal të tillë, përveç fakteve anësore që na detyrojnë ti marrim, ku jemi më të fokusuar për të besuar që të dhënat na vijnë të sakta, nga institucionet shtetërore apo vetëm nga kompanitë? Duke qenë se koha është e shkurtër, duhet të bëjmë tre raporte, përmbushim kërkesat e standartit të vitit 2019, plotësojmë vendimin e bordit EITI për të dorëzuar raportin brenda qershorit dhe përmbushim të gjitha pikat që Shqipëria do validohet për sa i përket çështjes së Raportit. Pra këto arsye na detyrojnë të ndjekim këtë lloj fryme, dhe detyrimisht për sa i përket termave të Raportit Fleksibël, ne do marrim një vendim në lidhje me besueshmërinë e të dhënave, sepse jemi të detyruar për shkak të kushteve, të procesit të plotësimit të kriterëve që ka vendosur Bordi EITI në vendimin e zgjatjes së afatit për dorëzimin e Raportit si dhe për të përmbushur kërkesat e validimit që fillon në fillim të vitit tjetër. Sigurisht që në situata të caktuara, MSG-ja dhe Bordi ka të drejtë të trajtojë çështje të cilat lidhen me implementimin e Standartit EITI, ku një nga kriteret specifike është besueshmëria e të dhënave. Nisma EITI është një proces që është i gjallë gjatë gjithë kohës, duke qenë se është i gjallë dhe evoluon,

detyrimisht nxjerr elementë të rinj që në një farë forme ne na detyron që të marrim vendime në përputhje me standartin në të ardhmen. Standarti i vitit 2019 do të përdoret vetëm këtë herë, më pas është Standarti i vitit 2023 që do të na sjellë të tjera situata dhe do të na japi mundësinë që të diskutojmë jo vetëm çështjen e besueshmërisë së të dhënave, por edhe çështje që lidhen me plotësimin e Standartit, por për këtë herë ne jemi të detyruar të vijojmë me përgatitjen e Raportit Fleksibël, e cila kërkon detyrimisht që MSG-ja të shprehet për sa i përket besueshmërisë së të dhënave .

**Znj. Anila Hajnaj:** Ne jemi të detyruar për kushtet që jemi dhe për udhëzimet që ka dhënë Sekretariati, përse ne duhet të pranojmë me patjetër që të dhënat janë të besueshme? Ne mund të themi që ne pranojmë që për këto tre raporte të merren të dhënat nga institucione shtetërore. Nëse ne nuk themi fjalën “të besueshme”, atëherë ne ngelemi pa plotësuar ato çfarë kërkon validimi. Ne gjithsesi kemi dalë një ndër vendet e para që kemi plotësuar shumë kushte, domethënë meqë është dicka që ne nuk e plotësojmë nga kërkesat aktuale nuk shkakton problem, por ama nëse ne e vendosim që të dhënat janë të besueshme, atëherë ajo do ngelet përgjithmonë. Ashtu sic tha z. Sami, a mund ta mendojmë një herë tjetër? Pra ne mund të themi që pranojmë që të dhënat të merren nga institucione shtetërore, por ama hedhim dyshimin që këto të dhëna nuk janë të sakta.

**Z. Genci Tërpo:** Ne nuk kemi pasur ndonjë eksperiencë nga institucionet shtetërore që të dhënat e tyre nuk janë të sakta. Nëse dini ndonjë rast nga Raportet EITI mund ta përmendni .

**Znj. Anila Hajnaj:** Ato çfarë ato raporte kanë thënë, mund të kenë qenë të sakta, por nuk janë të mjaftueshme sepse kanë mungesa, nëse ne themi që janë të besueshme atëherë e marrim të mirëqënë se gjithçka që ata thonë ashtu është.

**Znj. Emiliana Kola:** Ndoshta po ngatërrohem me konceptet sepse janë dy koncepte të ndryshme, Raporti Fleksibël që ka të bëjë me raportimin e njëanshëm dhe duhet të merret një vendim për këtë, pra a biem dakord që raportimi për këto tre raporte të jetë i njëanshëm dhe në rastin konkret nga institucionet qeveritare dhe pjesa tjetër ka të bëjë me besueshmërinë e të dhënave. Patjetër që është MSG-ja që i merr këto vendime, por që ne vetë që jemi pjesë të këtij procesi, ju që jeni liderat e këtij procesi, nuk keni besim në të dhënat që ne publikojmë sepse ne në fund të Raportëve i publikojmë zyrtarisht ato, dhe kushdo u referohet atyre të dhënave si plotësisht të besueshme. Nuk është çështja a i sjellin në rregull të dhënat apo kanë mungesa, por ato të dhëna që merren, a konsiderohen të besueshme apo jo. Siç e përmendëm dhe më lart, saktësinë e të dhënave e ka përgjegjësinë institucioni përkatës që i lëshon këto të dhëna, ne marrim përsipër të themi se këto të dhëna i konsiderojmë ose jo të besueshme. Kjo është kërkesë e Standartit, nuk po e kërkon Sekretariati. Këto çështje do të trajtohen sërish kur të bëhet gati Raporti i 2022, nuk do të mbeten pa u trajtuar sërish, pra nuk do të thotë që ne morëm një vendim tani dhe ky vendim nuk mund të rishqyrtohet sërish. Sigurisht që nëse ndonjë anëtar i MSG-ës ka dyshimin, problemin më të vogël që një proces nuk është i besueshëm, mund ta ngrëjë sërish si çështje.

**Znj. Anila Hajnaj:** Pra kjo do të thotë që informacionet të merren më shpejt nga institucionet shtetërore, kostoja do jet më e ulët për të tre raportet dhe koha më e shkurtër.

**Z. Dritan Dervishaj:** Znj. Emiliana kam përshtypjen se u zgjatëm më shumë seç duhej në lidhje me këtë temë.

**Znj. Emiliana Kola:** Sepse është shumë e rëndësishme z. Dritan.

**Z. Dritan Dervishaj:** Jam plotësisht dakord që është e rëndësishme, por siç e sqaruat dhe juve, koha është shumë e shkurtër. Unë jam dakord me propozimin, sepse me sa mbaj mend ne gjithë këto vite administrator të dhënat gjithmonë nga institucionet shtetërore i ka marrë, dhe ne si MSG i kemi miratuar në fund të ditës që më pas ato janë publikuar.

**Znj. Emiliana Kola:** Në momentin që jepet miratimi nga MSG-ja, ato janë të miratuara dhe konsiderohen si të besueshme. Kur i publikojmë ne këto të dhëna, Raporti i EITI-t del me emrin e Deloitte që ka qenë Administrator i Pavarur por edhe ne si Nisma për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse i konsiderojmë të besueshme të dhënat që ne i publikojmë.

**Z. Dritan Dervishaj:** Këtë po thoja, përderisa ne i kemi miratuar gjithë këto vite, nuk mund ti kemi



miratuar duke mos i kemi konsideruar të besueshme.

**Znj. Emiliana Kola:** Problemi i vetëm ka qenë se MSG-ja nuk është shprehur me fjalë.

**Z. Dritan Dervishaj:** Unë e kam të qartë, meqë rasti konkret kërkon një Raport Fleksibël dhe do jetë i njënjshëm le të themi, se nuk do merret nga kompanitë dhe nuk do bëhet kryqëzim, unë jam dakord, le ti konsiderojmë si të besueshme. Ose e lëmë për një kohë tjetër, por besoj do harxhojmë kohë duke qenë se është kërkesa e Standartit. Nuk po them të sakta, por të besueshme.

**Znj. Emiliana Kola:** “Të sakta” e ka përgjegjësinë institucioni që jep këto të dhëna, “të besueshme” për ne është tjetër gjë. Ne i marrim të mirëqëna kur na i japin ato të dhëna dhe i konsiderojmë si të besueshme.

**Z. Dritan Dervishaj:** Nuk kemi alternativë tjetër duke mos e miratuar do ngelet një çështje pezull.

**Znj. Emiliana Kola:** Pikërisht, do ta kemi përsëri pas vetes në Validimin tjetër.

**Z. Dritan Dervishaj:** Madje do të na pyesin edhe më tepër në lidhje me arsyen se përse nuk po i pranojmë si të besueshme të dhënat që ne marrim dhe publikojmë.

**Znj. Emiliana Kola:** Pikërisht!

**Z. Gledis Kalemi:** Kisha një pyetje në drejtim të anëtarëve që janë më skeptikë për këtë gjë. Kush është standarti i tyre për ti quajtur të dhënat e besueshme? Pra, si do të ndiheshin ata të qetë që këto të dhëna të konsideroheshin të besueshme?

**Z. Sami Nezaq:** Z. Gledis, problemi këtu është se ne nuk kemi një kapacitet për të dhënë këtë vlerësim dhe kjo është arsyeja pse ne po debatojmë. Z. Lorenc dha një fakt, por unë nuk kam asnjë fakt që të dhënat janë të pabesueshme, të besueshme, të sakta apo të pasakta. Pse nuk kam asnjë fakt? Sepse nuk e kam në tagrin tim të gjykoj mbi këtë gjë, ne i kemi marrë 10 vjet ato të dhëna dhe i kemi konsideruar ashtu siç na janë dhënë, nuk e kemi gjykuara sepse nuk kemi ne kapacitet ta gjykojmë këtë fakt.

**Znj. Emiliana Kola:** Jo z. Sami ne kemi kapacitet ta gjykojmë këtë gjë, sepse kemi prej caq vitesh që merremi me EITI-n ndaj edhe një herë po ju them që ne nuk do shprehemi që ato të dhëna janë të sakta, sepse nuk i kemi prodhuar vet ne si të dhëna, por në momentin që mua në çfarëdolloj institucioni, për çfarëdolloj arsyeje, në momentin që unë kërkoj një informacion dhe ai më vjen me një firmë dhe vulë nga drejtuesi, a e konsideron të besueshme këtë përgjigje apo informacion që të është dhënë?

**Z. Sami Nezaq:** Nuk e gjykoj në këtë kontekst, nuk e gjykoj nëse është i besueshëm apo jo, e bëj referencë që më ka ardhur nga një institucion dhe institucioni e mban përgjegjësinë nëse informacioni është i besueshëm apo jo.

**Znj. Emiliana Kola:** Jo të besueshmërisë, por mban përgjegjësi institucioni për saktësinë e të dhënave.

**Z. Sami Nezaq:** Jo unë, unë nuk kam të drejtë ta bëj këtë gjë në këtë frymë që po shtrohet problem. Ne i kemi përdorur ato të dhëna, dhe mua më duket e tepërt që ne të futemi në zonën etike të të dhënave nga institucionet zyrtare të Shqipërisë. Unë mund të them që po, të dhënat janë të besueshme, por kjo deklaratë e imja është caq relative sa nuk kam ku ta mbështes fare.

**Znj. Emiliana Kola:** Ideja është që ne po shprehim diçka që duhet ta bëjmë dhe do përplasemi me këtë gjë sërisht në validim, sërisht siç jemi përplasur prej vitesh me këtë gjë: “Pse Shqipëria nuk shprehet që të dhënat që publikon në raport janë të besueshme”, megjithatë jeni ju që merrni vendimet. Në qoftë se ju gjykoni që nuk duhet të shpreheni për këtë atëhere kjo do të ngelet në validim si një veprim korrigjues i pakryer sërisht edhe pas gjithë këtyre viteve, dhe sigurisht që do e kemi në vlerësimin përfundimtar këtë gjë. Nuk është një çështje fryme, është thjesht kërkesa e Standartit.

**Znj. Ola Mitro:** Ne e kemi detyrim ta plotësojmë këtë Standart, dhe padiskutim ne duhet ta plotësojmë që ta meritojmë pjesën e validimit, por në këtë lloj forme, sic po trajtohet këtu, që ne të shprehemi për këtë gjë vetëm për të plotësuar kërkesat e validimit dhe për të shmangur një përplasje në të ardhmen, më duket një argument jo i duhur. Sikurse e përmendi z. Sami, ne nuk jemi askushi për të thënë që të dhënat që japin institucionet shtetërore janë të besueshme, për më tepër në një vend si Shqipëria ku ne përballemi çdo ditë me të dhëna kontradiktore. Të paktën unë që jam në kontakt të vazhdueshëm me të dhënat që publikojnë institucionet, e them me bindje që jo gjithmonë këto të dhëna janë të sakta, e aq më tepër të

besueshme. Ndaj ne nuk mund ta mbajmë si peshë si MSG vetëm për të shmangur problemet e ardhshme me validimin dhe vetëm që ne të dalim me lajmin që Shqipëria validohet me pikë të larta në rastin e Transparencës së Industrisë Nxjerrëse, sepse në të vërtetë nuk është tamam kështu. Unë mendoj që ndonjëherë ne nuk e meritojmë atë status i cili na jepet ndaj ne nuk mund të rrezikojmë në këtë formë vetëm e vetëm për të shmangur problemet me validimin në të ardhmen.

**Znj. Emiliana Kola:** Znj. Ola kam përshtypjen se e ke keqkuptuar diskutimin. E para është që nuk po shtrohet në këtë mënyrë, unë përmenda që nëse gjykoni që nuk duhet marrë ky vendim vendosni, të merret vendimi me po se jo. Shpjegimi që u bë u realizua vetëm për të kuptuar kontekstin e vendimmarjes, vendimmarja ju takon vetëm juve, nuk ju detyrojmë aspak të merrni një vendim që ju nuk doni ta merrni, si dhe nuk është aspak e vërtetë që ne duam të dalim mirë në validim thjesht për të dhënë lajmin. Kjo është pjesë e punës sonë të përditshme që ne e bëjmë me pasion dhe përderisa ne jemi impenjuar sëbashku me ju, dhe po përpiqemi ta çojmë këtë gjë përpara prej vitesh, sigurisht që na jep edhe kënaqësi kur vlerësohemi mirë. Validimi është rezultati të gjithë punës që prej vitesh ne dhe Shqipëria është duke bërë, mëse ka gjëra që duhet ti përmirësojmë, atëherë le ti përmirësojmë sëbashku, nëse ka gjëra që nuk mundemi ti bëjmë, atëherë thjesht nuk mundemi t'i bëjmë, por nuk po detyron asnjëri askënd, jeni ju ata që vendosni për gjithçka.

**Z. Robert Beshello:** Unë mendoj që nuk duhet të vëmë në diskutim besueshmërinë e të dhënave që dalin nga AKBN-ja. Po flas si përfaqësues i AKBN-ësë.

**Znj. Emiliana Kola:** Nuk është vetëm AKBN-ja, po flasim për shumë institucione shtetërore. Nëqoftëse do të ishim në një raportim klasik, do të trajtonim edhe të dhënat që merren nga kompanitë dhe do të gjenim një mënyrë se si ti konsideronim dhe ato të besueshme, meqë jemi në rastin konkret që raportimi do duhet të bëhet i njëanshëm po flasim për të dhënat që vijnë nga institucionet shtetërore.

**Z. Genci Tërpo:** Edhe një herë, gjatë gjithë këtyre viteve eksperiencë me raportet EITI, a keni hasur ndonjëherë ndonjë problem i specifikuar edhe nga administrator i pavarur në lidhje me besueshmërinë e të dhënave në këto raporte?

**Z. Dritan Dervishaj:** Problematika e vetme me sa më kujtohet ka qenë vetëm me mbledhjen e të dhënave nga administrator i pavarur. Në lidhje me saktësinë ose besueshmërinë e të dhënave nuk më kujtohet të kemi pasur problematika të tilla. Gabimet kanë qenë nga kompanitë kryesisht, sic thatë dhe juve në lidhje me gabime njerëzore.

**Z. Genci Tërpo:** Fryma e Raportit Fleksibël ka si qëllim të lehtësojë pamundësinë në aspektin kohor apo pamundësinë për të raportuar në kohë dhe nga çfarë kemi vënë re, të paktën periudha e pandemisë e tregoi shumë qartë që pjesa më e madhe e institucioneve shtetërore raportuan në kohë, por ato që nuk raportuan në kohë ishin kompanitë private të cilat ishin të mbyllura, nuk kishin njerëz që të dërgonin informacione e shumë të tjera, pra kishte shumë element që në një farë forme detyronin shtyrjen e raportit në kohë. Sigurisht që raportet janë prodhuar dhe realizuar gjithnjë, por ky është edhe koncepti i Raportit Fleksibël që afron në kohë realizimin e një raporti në përputhje me Standartin dhe pregatit një informacion i cili realizohet nga një administrator i pavarur me të njëjtën frymë.

Pikë së pari, që ti trajtojmë me radhë çështjet, a jeni dakord me realizimin e Raportit Fleksibël?

**Z. Përparim Alikaj:** Dakord!

**Z. Dritan Dervishaj:** Dakord!

**Z. Robert Beshello:** Dakord!

**Z. Gledis Kalemi:** Dakord!

**Z. Sami Nezaj:** Dakord!

**Z. Lorenc Gordani:** Dakord!

**Z. Bilal Koci:** Dakord!

**Znj. Anila Hajnaj:** Mund të them që jam dakord të bëhen tre raportet me të dhënat zyrtare shtetërore. Nuk kemi pse të përmendim fjalën e pa/besueshme kur të bëhen termat e reja për vitin 2022 do e diskutojmë përsëri.

**Znj. Emiliana Kola:** Atëhere për besueshmërinë e të dhënave, secili shprehu votën e tij me gjykimin që dha.

**Z. Sami Nezaj:** Mendoj që çështjen e besueshmërisë ta shtyjmë për një herë tjetër dhe nëse ka kapacitete Sekretariati të na ofrojë një ekspertizë në lidhje me këtë çështje, nëse është e mundur.

**Z. Genci Tërpo:** Atëherë le t'i marrim me radhë dhe njëherë. Z. Bilal çfarë mendimi keni për besueshmërinë e të dhënave?

**Z. Bilal Koci:** Unë jam dakord! Të dhënat e institucioneve tona janë të sakta dhe të besueshme. Institucionet e tjera do të shprehen vetë .

**Z. Dritan Dervishaj:** Për mua është e pranueshme, siç e përmenda dhe më parë. Jam dakord!

**Z. Gledis Kalemi:** Unë patjetër që jam dakord, dhe do doja t'ju sillja në vëmendje dhe njëherë se për sa kohë që institucionet shtetërore kanë përgjegjësi ligjore lidhur me dokumentet që nxjerrin, atëherë patjetër që të dhënat e këtyre institucioneve duhen konsideruar të besueshme, aq më tepër që sektorët që e kanë detyrimin e raportimit të Raportit EITI kalojnë në një sërë filtrash nga institucione të ndryshme, pra ka dhe një kryqëzim të këtyre të dhënave. Nuk janë të dhëna që thjesht dalin nga vetëm një institucion dhe përfundojnë aty.

**Z. Lorenc Gordani:** Jam dakord pak a shumë me atë që tha z. Sami. Për të plotësuar pak më shumë, shpesh herë raportet e institucioneve shtetërore janë kontradiktore midis tyre. Po ta shihni, institucionet nuk nxjerrin raporte vjetore dhe ne dimë nga praktika e përditshme që nuk kanë kapacitete. Në këtë kuadër unë jam kundër, ose mund të abstenoj, por më shumë nuk mund të them që janë të besueshme sepse unë nuk kam kapacitetet për të thënë dicka të tillë dhe nuk më rezulton që diçka e tillë të jetë e vërtetë. Statistikat në Shqipëri kanë një problematikë të madhe në mbledhjen, referimin, përgatitjen e tyre me standartet që unë e di që i kërkon EITI. Për këtë arsye nuk marr dot përgjegjësi e të them që janë të sakta. Janë zyrtare, sigurisht.

**Znj. Mariola Kito:** Për sa i përket informacioneve që marrim nga institucionet shtetërore i konsiderojmë vërtet zyrtare. Për sa i përket besueshmërisë i vlerësoj mendimet e të gjithëve duke qenë se nuk kam qenë e përfshirë në raportet e mëparshme dhe në këtë temë nuk mund të shprehem realisht por siç e thashë, i konsideroj zyrtare. Çfarë jam dakord me znj. Emiliana është që nëse ne si MSG mund ta rishqyrtojmë më mbrapa specifikisht se çfarë mund të bëjmë ne si punë shtesë që të korigjojmë këtë pikëpyetje që ne kemi. Jam dakord edhe për Raportin Fleksibël.

**Znj. Ola Mitro:** //nuk u përgjigj

**Z. Përparim Alikaj:** Unë kam 12 vite që i quaj të besueshme këto.

**Znj. Anila Hajnaj:** Problemi është që me monitorimin që kam kryer vetë edhe brenda institucioneve shtetërore nuk më kanë rezultuar të sakta, megjithatë nuk flas për besueshmëri, por pranoj që të bëhen të treja raportet sipas të dhënave të shifrave zyrtare shtetërore.

**Z. Robert Beshello:** Për mua janë të besueshme të dhënat që dalin nga institucioni i AKBN-së.

**Z. Sami Nezaj:** Jam dakord që të treja raportet të realizohen kur se për çështjen nëse të dhënat janë të besueshme apo jo ta shtyjmë për një moment të dytë. Dua të sqaroj në lidhje me atë që tha z. Përparim, ne nuk na është kërkuar asnjëherë të shprehemi nëse janë të besueshme ose jo dhe i kemi konsideruar këto të dhëna si të dhëna zyrtare ose të dhëna që i marrim nga kompanitë, nuk e kemi ndërtuar asnjëherë logjikën mbi këtë gjë që të lëmë përshtypjen sot sikur nuk jemi koherent.

**Z. Përparim Alikaj:** Puna është që ne kemi punuar me këtë standart, tani po na kërkohet diçka për një rast ekstrem dhe te ky rast ekstrem ne themi le të mendo kemi njëherë. Unë nuk jam kundër që t'i rishikojmë këto gjëra në të ardhmen dhe t'i vëmë pikat mbi i ashtu sic duhet, por në këtë moment ekstrem duhet të jemi më shumë dakord.

**Z. Sami Nezaj:** Në këtë moment ekstrem ne jemi dakord që për shkak të rrethanave të pazakonta ne po i kalojmë këto tre raporte në mënyrë të njëanshme.

**Znj. Anila Hajnaj:** Ne jemi dakord për këto tre raporte, por problemi i besueshmërisë ne nuk e kemi pranuar ndonjëherë atë.

**Znj. Emiliana Kola:** Ne nuk e kemi diskutuar ndonjëherë besueshmërinë, është e gabuar të themi që nuk është pranuar.

**Z. Sami Nezaj:** Nuk është diskutuar më parë besueshmëria.

**Z. Përparim Alikaj:** Nuk na është kërkuar asnjëherë kjo gjë.

**Znj. Emiliana Kola:** Ju është kërkuar z. Përparim, tani jua rikujtoj unë. Kemi zhvilluar një mbledhje në Ministri për Validimin e Parë, jo këtë të fundit, me ekipin e validimit, me z. Aleks Gordy dhe z. Hugo Parett, ju është kërkuar nga ata, ndërkohë që ju është kërkuar edhe vjet nga z. Marc Burnet, pra përveçse është kërkuar gjatë kohës që ne bënim në mbledhje diskutimet për të dhënat, është kërkuar vazhdimisht.

**Z. Përparim Alikaj:** Znj. Emiliana ky është një opinion.

**Znj. Emiliana Kola:** Po patjetër ...

**Z. Përparim Alikaj:** Opinioni ka një veti që nuk vërtetohet dot.

**Z. Sami Nezaj:** Edhe nuk vërtetohet dot.

**Z. Përparim Alikaj:** Po, edhe mund të mos votohet dot, por ne kemi proceduar me opinion. Ne i kemi quajtur këto të dhëna që janë të besueshme, gjithashtu jam dakord që në një moment të dytë ta rishikojmë në të ardhmen se çfarë do të përfshijë ky opinion nga ana jonë. Çfarë kërkohet nga ajo se duket pak si e paqartë, çfarë kërkohet, ekzakt. Ne i kemi quajtur të padiskutueshme këto, kështu i kemi menduar por nëse ne themi se prit sepse ka akoma gjëra të diskutueshme, nuk i diskutojmë dot këtu në këto momente. Nuk po them që harxhuam kohë sepse gjithë secili nxjerr disa konkluzione, mëson disa gjëra të reja dhe në të ardhmen nuk do ta harxhojmë më këtë kohë . . . për këtë gjë që na kërkohet ne duhet ti japim një shtysë punës, të mos e lëmë të na ngeci.

**Znj. Emiliana Kola:** Në rregull!

**Z. Genci Tërpo:** Atëhere, pika e parë mendoj që kaloi, për sa i përket adoptimit të termave mbi Raportin Fleksibël. Çështja e dytë që duhet të trajtojmë është: *“Miratimi i Listës së Kompanive për raportin e vitit 2021”*. Ju jeni shprehur për raportimin e vitit 2019-2020, Znj. Emiliana jua ka përcjellë dhe listën e kompanive përkatëse për nga duhet të merret ky raportim. E keni parë besoj, keni ndonjë mendim. Kërkoni që të shtojmë apo të heqim diçka?

**Z. Përparim Alikaj:** Kisha një pyetje rreth subjekteve fotovoltaike. Kemi ndonjë përfaqësues këtu prej tyre?

**Znj. Emiliana Kola:** Përfaqësues të subjekteve në MSG?

**Z. Përparim Alikaj:** Po.

**Znj. Emiliana Kola:** Jo nuk kemi.

**Z. Lluka Gjergo:** Z. Përparim ju sqaroj unë në lidhje me subjektet fotovoltaike. Këto të dhëna janë nxjerrë nga Raporti i ERE-s. Janë subjekte që kanë shitur energji elektrike, që kanë prodhuar dhe kanë qënë në aktivitet.

**Z. Përparim Alikaj:** Në rregull, por unë po them se duhet të kemi një përfaqësues të këtyre subjekteve në MSG për të diskutuar rreth këtyre që parashtrihen, sepse kështu ato ngelen të panjohura për ne.

**Z. Genci Tërpo:** Znj. Mariola, në mos gaboj, Statcraft-i ka krijuar një platform lundruese fotovoltaike?

**Znj. Mariola Kito:** Është lundruese po, dhe ka qënë një projekt kërkimi dhe zhvillimi dhe realisht ka mbaruar ditët e fundit.

**Znj. Ola Mitro:** Ai ka përfunduar si projekt, por momentalisht nuk është në përdorim sepse ka pësuar një defekt.

**Znj. Mariola Kito:** Sigurisht, ai ka përfunduar sëfundmi por nuk është te kjo lista, sepse kam përshtypjen që kjo listë është marrë kohë më përpara.

**Znj. Ola Mitro:** Kam edhe unë një paqartësi. Ka shumë impiante që ende nuk kanë filluar ndërtimin.

**Znj. Mariola Kito:** Këtë do të thojë edhe unë. Një shembull është Akëri që akoma nuk ka filluar si një bazë fotovoltaike.

**Znj. Ola Mitro:** Asnjë nga ato.

**Z. Gledis Kalemi:** A mund të shtoj diçka? Nuk e di nga është marrë ky informacioni, por i janë referuar

regjistrin të licensimeve, pra ato të gjitha janë kompani të licensuara, por që nuk kanë qenë në prodhim gjatë vitit 2021 dhe aktualisht një pjesë e tyre vazhdon të mos jen; ende në prodhim, por thjesht kanë marrë licencën për prodhimin e energjisë elektrike.

**Z. Përparim Alikaj:** Atëherë për çfarë do raportojmë ne?

**Z. Gledis Kalemi:** Nëse do t'u referohemi 15 kompanive më të mëdhaja, në raport me sasinë e prodhimit të energjisë elektrike, besoj ato të gjitha i përkasin sektorit hidroenergjitik. Aktualisht janë, 11-12 impiante fotovoltaike në prodhim që të gjitha kanë një fuqi të instaluar prej 2 MËh.

**Znj. Emiliana Kola:** Mund t'ju sqaroj në lidhje me këtë? Energjia fotovoltaike ose energjia e rinovueshme nuk është kërkesë e detyrueshme e Standartit që duhet të raportojmë. Ju e dini që edhe hidroenergjinë që e kemi futur në vitin 2015 nuk është kërkesë e Standartit, bile jemi lider aktualisht dhe kjo është një gjë që duhet ndarë dhe me ju, Shqipëria konsiderohet si vendi lider kundrejt shteteve të tjera të EITI-t sepse ka filluar raportimet për hidroenergjinë në baza vullnetare që në vitin 2015, ndërkohë që në vendet e EITI është aktualisht duke u konsideruar që energjitë e rinovueshme me ndryshimet e reja të Standartit të futen dhe të bëhen pjesë e tij. Pra këto pesë subjekte që janë përzgjedhur këtu nuk është se e kanë raportimin e detyrueshëm, duke qenë se është ky trendi, ne i kemi futur që të kemi një pasqyrë të bazës ligjore, të licensimeve e shumë të tjera, por nuk është detyrim i Standartit raportimi i tyre, pra kjo është një gjë ekstra që ne e kemi shtruar duke u bazuar te trendi që është, që të gjitha vendet po kthejnë sytë nga energjitë e rinovueshme dhe specifikisht EITI kthen sytë fuqishëm nga energjitë e rinovueshme dhe besoj që së shpejti do të jenë pjesë e detyrueshme e raportimit EITI. Kjo është logjika që janë futur pesë kompani në këtë fushë, pra për të pasur një pasqyrë të situatës dhe të bazës ligjore aktualisht në Shqipëri.

**Znj. Ola Mitro:** Znj. Emiliana ndjesë, shumica e atyre kompanive nuk kanë marrë as licencimin përfundimtar nga ERE për aktivitetin, sidomos parqet eolike në Karaburun nuk janë të licensuara nga ERE, ose të paktën informacioni nuk është publik.

**Znj. Emiliana Kola:** Z.Gledis a mundesh të na e konfirmosh?

**Z. Gledis Kalemi:** Po, për parqet eolike nuk janë të licensuara nga ERE, unë fola për prodhuesit nga dielli, sic janë Karavastaja, SPV Blue dhe emrat e kompanive që janë në listë. Për parqet eolike është e vërtetë që nuk janë të licensuara, unë mund të ndaj me të gjithë ju një kopje e raportit vjetor të 2021 ku mund të shikoni të gjitha kompanitë që kanë qenë në aktivitet përgjatë gjithë atij viti si dhe e kanë prodhimin dhe të ndarë në baza mujore, përveç atyre vjetore sepse një gjë është që ti të jesh i licensuar dhe të figurosh që ti të kesh plotësuar kushtet për të marrë licensimin nga aktiviteti për prodhimin e energjisë elektrike, qoftë nga burimet ujore, qoftë nga dielli, era dhe tjetër gjë është të jesh në prodhim në momentin që merr licensën. Licensa është parakusht për të filluar prodhimin energjisë elektrike.

**Z. Genci Tërpo:** Z.Gledis a mund të kemi një informacion të saktë nga ana juaj përsa i përket kompanive që përmendët më lartë?

**Z. Gledis Kalemi:** Po patjetër, mund t'ju dërgoj që në këtë moment raportin vjetor ku janë gjithë kompanitë që kanë qenë në prodhim.

**Z. Genci Tërpo:** Në rregull, pra a jemi dakord ne të vendosim në listën e kompanive, edhe ato kompani të cilat prodhojnë energji solare për Raportin EITI?

**Znj. Anila Hajnaj:** Dakord!

**Znj. Ola Mitro:** Dakord!

**Znj. Mariola Kito:** Dakord!

**Z. Sami Nezaj:** Dakord!

**Z. Përparim Alikaj:** Po për energjinë eolike?

**Z.Gledis Kalemi:** Nuk ka nisur prodhimi akoma.

**Z. Përparim Alikaj:** Në rregull, të paktën të kemi listën e kompanive ku janë vendosur që të kemi një ide për të ardhmen.

**Z. Genci Tërpo:** Z.Gledis ju lutem të na e përcillni nëse është e mundur sot të gjithë anëtarëve të MSG-

është një listë të subjekteve të cilat prodhojnë në mënyrë që t'i përfshijmë edhe ato te Raportimi EITI.

**Z. Gledis Kalemi:** Patjetër. Kërkoni listën e kompanive të vitit 2021 apo kërkoni listën më të fundit?

**Z. Genci Tërpo:** Të vitit 2019, 2020, 2021.

**Z. Përparim Alikaj:** Znj. Emiliana unë kërkohj që të di më shumë rreth dy kompanive që janë për kërkim-zbulim. Kush janë këto kompani?

**Z. Bilal Koci:** Janë 14 kompani aktualisht për kërkim-zbulimi dhe le të zgjedhim dy prej tyre sipas dëshirës, se kush janë këto kompani listën e plotë ia kam dorëzuar Z. Lluka.

**Z. Sami Nezaj:** Z. Lluka a mund të na dërgoni listat e vitit 2021?

**Z. LLuka Gjergo:** Po patjetër, veçse nuk kemi diskutuar më parë për emrat e kompanive.

**Z. Bilal Koci:** Kemi diskutuar në bazë të numrit.

**Z. Përparim Alikaj:** Numrin do ta diskutojmë në bazë të emrit.

**Znj. Emiliana Kola:** Znj. Ola në bazë të raporteve të kompanive që u përmendën më lartë mund ta marrim në shqyrtim futjen e raportit të vitit 2022, edhe pse tashmë na kërkohen thjesht kompanitë prodhuese të viteve 2019, 2020 dhe 2021.

**Znj. Ola Mitro:** Ndoshta mund të ishte një promovim për të ardhmen. Besoj që gjatë vitit 2022 nuk ka ndonjë kompani që ka hyrë në prodhim, por gjithsesi për të qenë të saktë.

**Znj. Emiliana Kola:** Po patjetër.

**Z. Genci Tërpo:** Atëherë duke qenë se më vonë do të kemi si detyrim edhe plotësimin e raportit të vitit 2022, le të përcillet edhe pjesa e kompanive që i përkasin vitit 2022, paçka se ne si detyrim kemi vetëm mbi kompanitë e viteve 2019, 2020 dhe 2021.

Pra që ta bëjmë më të përmbledhur, jemi dakord për miratimin e listës së kompanive për raportin e vitit 2021, duke përfshirë edhe kompanitë që do na serviren nga Z. Gledis për sa i përket energjisë së rinovueshme solare?

**Z. Sami Nezaj:** Dakord!

**Z. Përparim Alikaj:** Dakord!

**Znj. Anila Hajnaj:** Dakord!

**Znj. Ola Mitro:** Dakord!

**Z. Bilal Koci:** Dakord!

**Z. Dritan Dervishaj:** Dakord jemi të gjithë!

**Z. Genci Tërpo:** Çështja e katërt e axhendës u diskutua se ne e filluam nga pika e katërt për të vijuar me Çështjen e parë, le të kalojmë të çështja e pestë : *“Diskutim dhe Vendimmarrje për përcaktimin e termit “Projekt” për raportimin EITP”*, Znj. Emiliana mund t’ju sqarohj gjithcka nëse nuk e keni të qartë këtë pikë.

**Znj. Emiliana Kola:** Nëse e kemi znj. Moza në linjë do të më duhej të më jepte një suport. Ju e dini që me Standartin e vitit 2019, ju është kërkuar të gjitha vendeve EITI që raportimi të bëhet në bazë projekti. Ju jeni shprehur me komentet tuaja edhe për rishikimin e standartit. Ne e kemi konsideruar si projekt numrin e licensave që ka një kompani, ndërkohë që raportimi në bazë license në Shqipëri është thujse i pamundur, sepse një pjesë e kompanive nxjerrëse mund të keni dy ose më shumë licensa dhe një numër NIPT-i, dhe raportimin që bëjnë në dogana, tatime apo kudo e bëjnë në bazë NIPT-i dhe jo license. Duke qenë se e kemi të pamundur raportimin në bazë license, pra të dhënat të merren në bazë license dhe të raportohen në Raportin EITI në bazë license duhet të biem dakord për përkufizimin e termit “Projekt”. Pra, çfarë do quajmë në “Projekt”? Mund të jetë zona minerare, mund të jetë në bazë të numrit të NIPTI-t. A isha e qartë për Çështjen?

**Znj. Anila Hajnaj:** Për mendimin tim të jetë zona minerare.

**Znj. Emiliana Kola:** Do të doja të kishim një konfirmim nga znj. Moza nëse informacioni mund të merret në këtë mënyrë, pra në bazë të zonës minerare apo në bazë të numrit të NIPTI-t që një kompani e caktuar ka, pra si t’i kërkohj më të dhënat dhe në vijim, sepse ky vendim është një vendim i cili do vlejë dhe për raportet në vijim, pra përkufizimi i termit “Projekt”. Thashë që në bazë license nuk është e mundur që

të merret informacioni sepse kompanitë e mbledhin mineralin në një vend, pavarësisht nga licenca. Jam e saktë z. Përparim?

**Z. Përparim Alikaj:** Je shumë e saktë, është e vërtetë, këtë problem e kemi diskutuar disa herë të tjera, ky është një problem i vështirë. Një kompani mund të ketë disa licensa dhe më interesantja se nuk i ka vetëm minerare, mund t'i ketë edhe bujqësore e të tjera që përzihen bashkë. Ne na intereson që t'i kemi jo vetëm minerare, por edhe me bazë zone, me bazë projekti, sepse ajo tregon se çfarë detyrimesh ka kjo kompani për një zonë të caktuar nëqoftëse kjo gjë mund të bëhet, ne do të na ndihmonte shumë institucioni i tatimeve.

**Znj. Emiliana Kola:** Meqë znj. Moza nuk është për momentin në mbledhje, ju z. Përparim keni eksperiencë në këtë fushë, a do të ishte e mundur që disagregimi i të dhënave dhe informacioneve që ne kërkojmë nga kompanitë apo nga institucionet e tatimeve, doganave për kompanitë do të ishte më e thjeshtë që të merret në bazë license ?

**Z. Përparim Alikaj:** Shumë e thjeshtë. Mund të merret në bazë license, por mund të merret dhe nga AKBN-ja.

**Z. Lluka Gjergo:** Merret vetëm prodhimi, ndërsa eksporti dhe të ardhurat nuk merren dot.

**Z. Përparim Alikaj:** Eksporti dhe të tjerat kanë të tjera parametra pastaj, kjo është vështirësia. Ne do të na interesonte shumë t'i kishim në bazë license .

**Znj. Emiliana Kola:** Znj. Anila se ju keni eksperiencë. Raportimi në bashki bëhet në bazë license apo subjekti?

**Znj. Anila Hajnaj:** Për shkak të pandemisë, disa kompani u përjashtuan nga renta, ato përpunuese, dhe këto kompani përpunuese për procesin e nxjerrjes së mineralit nuk paguanin rentë por në momentin që ata e përpunonin apo e eksportonin ata duhej të paguanin 3% rentë. Dhe kjo rentë, përshembull i gjithë minerali i mbledhur në qytetin e Bulqizës përpunohej në qytetin e Elbasanit dhe renta i takonte qytetit të Elbasanit domethënë, qyteti i Bulqizës nga kompanitë e mëdha nuk është paguar, prandaj unë kërkoj, me forcë të madhe dhe besoj që të gjithë kolegët do bashkohen, që të jetë në bazë të vendburimit dhe çdo kompani në bazë vendburimit të kenë numra NIPT-i sekondarë. Kjo do të thotë që çdo vendburim të ketë NIPT-in e tij. Qyteti i Bulqizës ka humbur miliona para për këtë arsye .

**Z. Përparim Alikaj:** Është shumë e vërtetë kjo gjë.

**Znj. Emiliana Kola:** Sapo u konsultova dhe me z.Lluka, nëse e bëjmë me bazë vendburimi raportimin, me bazën ligjore që kemi aktualisht , kjo gjë nuk mund të bëhet, pra ne nuk na shërben. Ta mendojmë në vijim se si mund ta shtyjmë këtë gjë që të bëhen ndryshime nëse është e mundur .

**Znj. Anila Hajnaj:** Është shumë e thjeshtë, AKBN-ja duhet të raportojë sepse asaj i shkojnë raportet se sa ka qenë prodhimi pas çdo muaji apo tre muajsh .

**Z. Lluka Gjergo:** Prodhimin në sasi e ndan, por rentën dhe të ardhurat nuk i ndan dot. Eksporti është me NIPT, nuk është me licensa.

**Znj. Anila Hajnaj:** Atëherë duhet të bëjmë amendime në ligj, pasi kjo është shumë e rëndësishme.

**Z. Lluka Gjergo:** Të shikohet ana ligjore është tjetër problem, por po flasim në kuadrin ligjor që kemi aktualisht.

**Znj. Emiliana Kola:** Duhet të shohim në vijim një mënyrë se si mund ta shtyjmë çështjen.

**Znj. Anila Hajnaj:** Por kjo gjë mund të kryhet, pa u përjashtuar nga ligji që doli gjatë pandemisë për kompanitë përpunuese. Më parë ata jepnin rentë.

**Z. Lluka Gjergo:** Znj. Anila por ju sapo e thatë, ndahet prodhuesi nga përpunuesi, jo licensa me licensën.

**Znj. Anila Hajnaj:** Sepse në program faktikisht kur eksportohej deklarohet qyteti i Elbasanit.

**Znj. Emiliana Kola:** Znj. Anila që të të sqaroj, ne e njohim problemin si nga ju si nga raportet që ndoshta nuk është e drejtë kështu por aktualisht kemi këtë bazë ligjore. Ne kemi diskutuar për Raportimin EITI në lidhje me përkufizimin e termit “Projekt”. Aktualisht gjëja më e mirë që ne mund të bëjmë, me bazën ligjore që kemi, është që të quajmë projekt numrin e NIPT-it, duke qenë se kompanitë kanë NIPT-e sekondare, apo jo Z. Përparim?

**Z. Përparim Alikaj:** Po , kanë dhe NIPT-e sekondare kur kanë disa objekte.

**Z. Lluka Gjergo:** Një gjë që ne mund të ndajmë është që në qoftë se një kompani minerare ka aktivitet në ndërtim apo turizëm, atëherë raportimi të jetë më vete për aktivitetin minerar dhe me vete për aktivitetin në turizëm, kjo është një gjë e mundshme, por t'i ndajmë licensë më licensë është absurditet ta kërkos, kur çdo veprim apo aktivitet financiar bëhet me NIPT-in, nuk bëhet me numrin e licensës.

**Znj. Emiliana Kola:** Ky është një diskutim që ne e kemi ngritur vazhdimisht prej kaq vitesh dhe nuk i kemi dhënë akoma një zgjidhje, tani, diskutimi që ne po bëjmë është se çfarë do quajmë ne projekt me bazën ligjore që ne kemi aktualisht, pra çfarë na përafrohet më mirë me bazën ligjorë që disponojmë, për të lehtësuar raportimin. Ta kemi informacionin sa më të disagreguar që të jetë e mundur, deri në pikën ku ne kemi mundësi. Pra, më mirë është që të quajmë projekt numrin e NIPT-it që kompania ka, atëherë të marrim vendimin që të quajmë projekt numrin e NIPT-it.

**Znj. Anila Hajnaj:** Po këto kompanitë që kanë edhe biznese të tjera si raportojnë në shtet? Për të gjitha bizneset raportojnë vetëm më një numër NIPT-i?

**Z. Lluka Gjergo:** Një kompani ndërtimi nuk paguan rentë, rentën e paguan kur punon me mineraret.

**Znj. Anila Hajnaj:** A nuk kanë NIPT-e sekondare?

**Z. Lluka Gjergo:** Detyrimet paguhen në bazën e NIPT-it.

**Znj. Emiliana Kola:** Nëse një kompani merret edhe me ndërtim, por ama ka dhe licensë minerare, ajo rentën, tatimet apo taksat specifike i paguan vetëm për pjesën e aktivitetit minerar që ka, nuk paguan rentë apo tatime të tjera specifike për ndërtimin.

**Znj. Anila Hajnaj:** Po sikur të ketë ndonjë kompani që mund të ketë edhe minerar, hidrocentral, fotovoltaike, eloike?

**Z. Lluka Gjergo:** Përsëri janë të ndara. Për kompanitë hidroenergjitike ka bilanc tjetër, për pjesën minerare ka bilanc tjetër.

**Znj. Anila Hajnaj:** Në rregull, por shteti duhet ta jap si informacion këtë gjë.

**Z. Lluka Gjergo:** Pikërisht , kjo është ajo gjë që duhet të përcaktojmë, çfarë të quajmë "Projekt". Të quajmë projekt një kompani që ka dhe HEC-e dhe aktivitet minerar nuk e bëjmë dot se janë dy aktivitete të ndryshme. Këtë gjë duhet ta kërkojmë të ndarë. Me licensë nuk mund t'i ndajmë sepse është e pamundur t'i kërkos një kompanie që ka pesë licensa të të japi informacion për cdo licensë. Në sasi minerali mund t'i ofrojë, por të dhënat ekonomike nuk mundet të t'i ofrojë. Në AKBN raportohet në bazë license, kurse në tatime nuk raportohet në bazë license, në tatime raportohet me NIPT.

**Z. Përparim Alikaj:** Po mirë në AKBN a përcaktohet se sa është renta minerare?

**Z. Lluka Gjergo:** E jep në total, dhe renta minerare është në doganë, sepse pa paguar rentën nuk eksportohet.

**Z. Dritan Dervishaj:** Deklarohet renta minerare në AKBN , z.Përparim.

**Z. Lluka Gjergo:** Renta deklarohet në total në AKBN, për shembull ju si fabrikë keni dy licensa, si renta e gëlqerorëve dhe renta e argjilës jepet e ndarë? Jo, jepet në total, besoj.

**Z. Dritan Dervishaj:** Paguhet renta total nga produkti që është i shitur, pra që është çimentoja.

**Z. Sami Nezaj:** Nuk jepet e ndarë në bazë NIPT-i, por në bazë license.

**Znj .Emiliana Kola:** Z.Sami kjo gjë nuk mund të bëhet, nuk e kemi të mundur me legjislacionin aktual. Në bazë license do ishte mirë.

**Z. Sami Nezaj:** Renta kur deklarohet në doganë nuk deklarohet sipas NIPT-eve por sipas ...

**Znj. Emiliana Kola:** Me NIPT vetëm .

**Z. Sami Nezaj:** Në rregull, atëherë kjo mbetet si e vetmja mundësi, sepse është e pamundur për të mbledhur të dhënat në një mënyrë tjetër. Do të ishte shumë mirë ajo që tha znj.Anila, por është e pamundur praktikisht .

**Z. Përparim Alikaj:** E kemi zhvilluar kaq herë këtë temë.

**Znj. Anila Hajnaj:** Me sa kam konstatuar unë, më shumë problem është te këto kompanitë përpunuese se sa te kompanitë që mund të kenë dy tre licensa për shembull një në Kukës e një në Pogradec, sepse



varesh nga pika doganore që ata eksportojnë. Ndonëse kanë pasur të njëjtin NIPT, kam vërejtur që kanë pasur vendburime të ndryshme. Është më e vështirë për kompanitë përpunuese.

**Z. Lluka Gjergo:** Znj. Anila për të ndarë kompanitë përpunuese nga kompanitë prodhuese mund ta realizojmë, por brenda një kompanie prodhuese ta ndash me licensa është e pamundur.

**Z. Përparim Alikaj:** Me këtë kuadër ligjor, realisht është e pamundur.

**Z. Lluka Gjergo:** Po, sepse me këtë kuadër ligjor që ne kemi aktualisht, tatimet dhe doganat punojnë me NIPT, kurse AKBN-ja dhe aktiviteti prodhues është me licensë.

**Znj. Anila Hajnaj:** Në rregull atëherë, le të pranojmë për këto tre raporte, por duhet të propozojmë ndryshime të ligjit.

**Znj. Emiliana Kola:** Mund ta zhvillojmë në vijim, të bëjmë diskutime dhe të përpiqemi se si mund t'i ndryshojmë gjërat, por aktualisht jemi te kjo situatë.

**Znj. Anila Hajnaj:** Le të zgjedhim atë që është më e drejta për tu bërë në këtë situatë.

**Z. Lluka Gjergo:** E drejta është njëra anë dhe mundësia për ta realizuar është tjetër gjë. Flasin me kuadrin ligjor që kemi, deri ku kemi mundësi ne për të ndarë projektin.

**Znj. Emiliana Kola:** Aktualisht, zgjedhja më e mirë që ne kemi për një disagregim sa më të madh, pra që ne të arrijmë sa më thellë te të dhënat është NIPT-i, pra konsiderimi si “Projekt” i NIPT-it të kompanisë.

**Z. Përparim Alikaj:** Në kuadrin ligjor mund të propozohet që të kemi NIPT-e të ndryshme, kjo mund të jetë një zgjidhje. Çdo aktivitet të ketë një NIPT më vete.

**Z. Dritan Dervishaj:** Z. Përparim, shumë NIPT-e sjellin pasoja të tjera, ka më shumë abuzime, ka të mira por ka dhe të këqija.

**Z. Përparim Alikaj:** Po le të ketë NIPT-e sekondarë .

**Z. Dritan Dervishaj:** Institucionit të tatimeve u krijon akoma më tepër probleme.

**Znj. Emiliana Kola:** Jemi dakord që të shprehemi për termin “Projekt” që të konsiderojmë NIPT-in si të tillë?

**Z. Genci Tërpo:** Atëhere, a jemi dakord të gjithë për të konsideruar NIPT-in si “Projekt”?

**Znj. Anila Hajnaj:** Dakord!

**Z. Përparim Alikaj:** Dakord!

**Z. Dritan Dervishaj:** Dakord!

**Z. Bilal Koci:** Dakord!

**Z. Sami Nezaj :** Dakord !

**Z. Genci Tërpo:** Në rregull, atëherë le të vazhdojmë me çështjen e fundit , pika e gjashtë që ka të bëjë me: “*Diskutim dhe Vendimmarrje për veprimin korrigjues të Validimit nr.4 (Kërkesa 2.2 a.i.v e Standartit EITI)* “. Atëherë, nëse hapim Standartin EITI , pika 2.2 lidhet me kontratat dhe alokimin e licensave dhe pika 4 është që nëse ka ndonjë devijim nga legjislacioni aktual apo rregulloret e Qeverisë lidhur me transferimin apo dhënien e licensave.

**Z. Përparim Alikaj:** Nuk e di nëse kanë ndonjë ndryshim rregulloret. Me sa di unë, kohët e fundit nuk kanë pasur ndryshime.

**Z. Genci Tërpo:** Pra, jemi duke folur për devijime të paligjshme.

**Z. Lluka Gjergo:** Ligji minerar zbatohet për të gjithë njëllor apo ka devijime, z.Përparim ?

**Z. Përparim Alikaj:** Absolutisht nuk ka pasur devijime, ligji minerar zbatohet.

**Z. Lluka Gjergo:** Nëse z. Berti është në linjë, kisha një pyetje rreth çështjes nëse AKBN-ja kontrollet i bën selektive apo i bën zbatuar në ligj njëllor për të gjitha kompanitë?

**Z. Robert Beshello:** Kur do të marrësh një licensë për kërkim – zbulim, janë të njëjta gjëra që kërkohen prej të gjithë.

**Z. Lluka Gjergo:** Por a zbatohet fiks ligji?

**Z. Përparim Alikaj:** Zbatohet, sepse do futesh në tender.

**Z. Lluka Gjergo:** Në tender janë të gjithë të barabartë, trajtohen të gjithë njëllor.

**Z. Përparim Alikaj:** Tenderi atë kuptim ka, pastaj se çfarë mund të bëhet jashtë kësaj ne nuk e dimë, por

dhe ai (kompania shkelëse e ligjit) shkon drejt tenderit për çdo gjë.

**Z. Lluka Gjergo:** Dhe përderisa në ligjin shqiptar ekziston ankimimi, janë pezulluar shumë licenca ...

**Z. Përparim Alikaj:** Unë nuk mund të them që është kristal, mund të jenë bërë dhe marifete gjatë këtyre 10-15 vjetëve, nuk mund ta them dot këtë, por ai të tregon ligjin dhe të thotë që çdo gjë është bërë sipas ligjit, pra që gjithçka është bërë konform ligjit. Ligji i vitit 2010, me gjithë mangësitë e veta sepse unë kam rezervat e mia për atë ligj, është zbatuar.

**Z. Lluka Gjergo:** Duhet të rishikohet ligji është tjetër gjë.

**Z. Përparim Alikaj:** Po, duhet të rishikohet. Jemi lodhur shumë për përmirësimin e atij ligjit, dhe disa gjëra të vogla mund të themi që dhe janë bërë.

**Z. Lluka Gjergo:** Kanë ngelur akoma për tu bërë.

**Z. Genci Tërpo:** Pra, çfarë vendimi do marrim rreth kësaj çështjeje?

**Z. Përparim Alikaj:** Ligji është zbatuar.

**Z. Lluka Gjergo:** Pra, çfarë mendimi kemi ne për këtë çështje , sepse kështu nuk mund të jemi plotësisht të qartë.

**Z. Përparim Alikaj:** Devijime të hapura kundra ligjit nuk ka, por se çfarë bëhet më tej ne nuk dimë gjë për këto 10-15 vite, por sidomos nga viti 2010 e më sipër me ligjin e ri. Disa gjëra i ka bërë më të forta sec duhen ky ligj i ri. Për shembull ligji i vitit 1993 ishte një ligj më tolerant, kompanitë e huaja e pranorin shumë më mirë atë ligj. nuk them se nuk duheshin bërë korigjime, por u bënë aq shumë fortësime mbi këtë ligj. Ne me këtë ligj jemi tashmë, duhen rregulluar disa gjëra paçka se janë rregulluar disa të tjera, sepse shikoni ku jemi sot. Nuk kemi asnjë sondë shpimi që rrotullohet për kërkim – zbulim në bakër.

**Z. Lluka Gjergo:** Një rishikim i ligjit duhet bërë, sepse te kërkim-zbulimi jam dakord, por ama janë specifikat e ekonomisë së tregut që e kufizojnë atë. Iku koha e ndërmarrjeve gjeologjike që punonte shteti. Me informacionin e SHGJSH-së janë 14-15 subjekte në kërkim- zbulim.

**Z. Përparim Alikaj:** Janë por, praktikisht mund të jenë disa nga kromi apo barki, por për kërkim-zbulim janë shumë pak.

**Z. Genci Tërpo:** Atëherë, lidhur me këtë pikë si do shprehemi. Nuk dini ndonjë rast i cili mund të ketë ndonjë devijim për sa i përket marrjes së licensës ndryshe nga ajo që përcakton ligji?

**Z. Përparim Alikaj:** Zyrtarisht , të gjitha janë marrë ligjërisht.

**Z. Genci Tërpo:** A u jepet mundësia kompanive që të ankimojnë vendime?

**Z. Përparim Alikaj:** U jepet! Po, patjetër. Ligjet i kemi në rregull, por kur vjen puna te zbatimi aty hasen problemet e vërteta.

**Z. Genci Tërpo:** Në rregull, lidhur me këtë kjo ishte pika e fundit e diskutimit. Mendoj që në vijim, përveç mbledhjeve që mund të vazhdojmë edhe në të njëjtën formë t'i kryejmë, pra me platformat online, do të ishte e mira që në një mbledhje të caktuar ne të takohemi edhe fizikisht, sepse mendoj që takimet fizike janë më frytdhënëse dhe efektive si për të debatuar, si për analizën që lidhen me vazhdimësinë dhe funksionimin e EITI-t në të ardhmen, duke qenë se jemi dhe përballë faktit që do të kemi një standart të ri që do të na kërkojë detyra të tjera për tu zbatuar. Pasi të diskutojmë edhe me kryetarin e MSG-së ,do të mundohemi që në një nga mbledhjet e radhës të takohemi qoftë në zyrat tona për të krijuar një ambient për tu takuar, apo qoftë edhe në ambientet e Ministrisë për të bërë një mbledhje fizike të MSG-së ku mund të trajtojmë edhe çështje të tjera përveç faktit që thashë që diskutimi në platformën online është i mirë. Ju falenderoj të gjithëve. Sot ishte një mbledhje e frytshme, një mbledhje e gjatë, por që dolëm me disa vendime që janë shumë të rëndësishme për mbarëvajtjen e veprimtarisë së EITI në vijim, si dhe është për tu theksuar që gjithmonë keni qenë të vëmendshëm, të kujdesshëm, paralelisht dhe suportues për sa i përket të gjitha proceseve që kanë kaluar zyrat e AlbEITI-t deri më sot. Natyrisht që jemi dhe në pritje të materialeve që do të na nisen nga z.Gledis, të cilat po i konsiderojmë të miratuara për sa i përket përfshirjes së kompanive në raportim lidhur me të tre raportet të viteve 2019, 2020 dhe 2021 dhe në vijim do t'ju përcjellim dhe termat e referencës dhe cdo lloj materiali tjetër që lidhet me funksionimin e EITI në

vijim përse i përket vijueshmërisë së projekteve në përputhje me Standartin, por dhe në përputhje me të gjitha objektivat që i kemi vënë vetes për t'i realizuar gjatë vitit 2023 në kuadrin e raporteve apo projekteve për sa i përket çështjeve EITI. Ju falenderoj të gjithëve!

**Mbledhja zgjati : 01:47:49**